



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2025

V E N D I M

Nr. 646, datë 23.09.2025

P Ë R

**TRANSFERIMIN E GJYQTARES ZNJ. {...}
NË PROCEDURËN E LËVIZJES PARALELE, NË GJYKATËN E SHKALLËS SË
PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 23.09.2025, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin mbi Projekt vendimin “Për transferimin e gjyqtares znj. {...}, në procedurën e lëvizjes paralele, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, përgatitur nga relatori z. Albens Tabaku, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për miratimin e këtij projekt vendimi,

V Ë R E N

I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor¹ me disa vendime të datës 27.02.2025, ka vendosur hapjen e disa procedurave të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në gjykatën administrative të shkallës së parë. Ndër to, konkretisht me vendimin nr. 107, Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës civile.

1.1 Afati i kandidimit për këtë procedurë të lëvizjes paralele si më lart, u përcaktua deri më datë 17.03.2025.

2. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 107, datë 27.02.2025², aplikuan 17 (shtatëmbëdhjetë) kandidatë, sipas tabelës së mëposhtme:

¹ Në vijim referuar si Këshilli

² Në vijim referuar si Vendimi 107/2025

Nr.	Vendimi 107/2025 (Civile)
1.	{...}
2.	{...}
3.	{...}
4.	{...}
5.	{...}
6.	{...}
7.	{...}
8.	{...}
9.	{...}
10.	{...}
11.	{...}
12.	{...}
13.	{...}
14.	{...}
15.	{...}
16.	{...}
17.	{...}

3. Për këtë pozicion të lirë, në përfundim të fazës së parë të verifikimit të kriterëve ligjore, rezultojnë të jenë kualifikuar me vendime nga Këshilli kandidatët: {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...} dhe {...}, ndërsa për kandidaten {...} Këshilli ka vendosur shkualifikimin.

4. Në vijim, në përfundim të procedurës së renditjes, Këshilli me vendimin nr. 436, datë 22.07.2025 ka vendosur:

1. *Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 107, datë 27.02.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:*

1. Z. {...}
2. Znj. {...}
3. Z. {...}
4. Z. {...}
5. Znj. {...}
6. Z. {...}
7. Znj. {...}
8. Z. {...}
9. Znj. {...}
10. Znj. {...}

2. *Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.*
3. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.*

5. Vendimi i Këshillit nr. 436, datë 22.07.2025, rezulton t’i jetë komunikuar rregullisht të gjithë kandidatëve. Nga Zyra e Protokollit të Këshillit është konfirmuar se më datë 29.07.2025, të gjithë kandidatët kanë marrë dijeni, që vërtetohet me aktin “lajmërim marrje” të datës 29.07.2025 dhe nuk rezulton të jetë ushtruar e drejta e ankimit, nga data e njoftimit të vendimit, e cila ishte brenda 5 ditëve.

5.1 Në këto kushte vendimi i Këshillit nr. 436, datë 22.07.2025 është i formës së prerë.

6. Ndërkohë, ka rezultuar se kandidati {...} i renditur i pari në këtë procedurë me anë të postës elektronike të datës 30.07.2025, protokolluar në Këshill me nr. 4369 prot., datë 30.07.2025 dhe kërkesës së datës 31.07.2025, protokolluar në Këshill me nr. 4625 prot., datë 01.09.2025 ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë me nr. 107/2025, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke parashtuar se shprehte vullnetin për të hequr dorë nga kandidimi për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 107/2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

6.1 Pas shqyrtimit të kërkesës së kandidatit {...}, me vendimin nr. 604, datë 16.09.2025, Këshilli ka vendosur mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 107, datë 27.02.2025, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

7. Si rrjedhojë e tërheqjes nga kandidimi së kandidatit {...}, renditja e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin 107/2025, miratuar më parë me vendimin nr. 436, datë 22.07.2025 nga Këshilli, tashmë rezulton të jetë si më poshtë:

1. Znj. {...}
2. Z. {...}
3. Z. {...}
4. Znj. {...}
5. Z. {...}
6. Znj. {...}
7. Z. {...}
8. Znj. {...}

9. Znj. {...}

8. Në kuadër të përgatitjes së procedurës së transferimit, u kërkua informacion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ku ushtron funksionin e gjyqtarit znj. {...}, në lidhje me numrin e çështjeve gjyqësore në gjykim, çështjeve gjyqësore që ndodhen në fazë shqyrtimi në seancë gjyqësore dhe ato në fazën e konkluzioneve përfundimtare.

8.1 Në përgjigje të kërkesës, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 12.09.2025 dhe 15.09.2025, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, është përcjellë informacioni ku bëhet me dije Këshilli se, nga verifikimet e kryera deri më datë 12.09.2025, gjyqtare {...}, ka në gjykim gjithsej 174 çështje, nga të cilat 10 çështje penale janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare dhe 9 çështje civile në shqyrtim në seancë gjyqësore, ndërsa në lidhje me numrin e çështjeve penale me të pandehur nën masë sigurimi arresti dhe fazën në të cilën ndodhen, ka në gjykim gjithsej 5 çështje penale , me objekt “Dërgim në gjyq”.

9. Sa sipër, në respektim të parashikimeve të Vendimit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, relatori i kësaj procedure përzgjedhje përgatiti projekt vendimin “Për transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i cili pasi u miratua në mbledhje nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pas konstatimit si të plotë të dokumentacionit të administruar për kandidaten në këtë procedurë përzgjedhjeje, iu kalua për shqyrtim Mbledhjes Plenare të Këshillit.

9.1 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pasi shqyrtoi dhe informacionin e ardhur nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë në lidhje me numrin e çështjeve gjyqësore në gjykim nga gjyqtarja që do të transferohet, konkludoi se duhet t’i propozojë Mbledhjes Plenare në kuadër të shqyrtimit të projekt vendimit të vlerësojë mbi çështjet në gjykim që ka, se duhet të ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë të cilat ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor, si edhe të gjitha çështjet ku është caktuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

II. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI

10. Projekt vendimi “Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, u shqyrtua nga Mbledhja Plenare e Këshillit e cila vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar në funksion të procedurës së renditjes, përveç edhe korrektësinë e projektvendimit.

11. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidatja znj. {...} renditet e para në këtë procedurë lëvizje paralele, Këshilli vlerëson së është rasti për miratimin e Projekt vendimit të propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e renditur atë të parën dhe për rrjedhojë ta transferojë në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin 107/2025, të Këshillit.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative; në shkronjën “ç”, të nenit 85 e 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; në pikën 7, 10 dhe 12, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në Vendimet e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, nr. 436, datë 22.07.2025 “Për miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 107, datë 27.02.2025”, nr. 604, datë 16.09.2025 “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 107, datë 27.02.2025, për kandidatin z. {...}”, Këshilli i Lartë Gjyqësor

V E N D O S I:

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Gjyqtarja znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë të cilat ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale për të cilat ka filluar shqyrtimi, me të pandehur që ndodhen në masat e sigurimit “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”, si edhe të gjitha çështjet ku është caktuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.
3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 29.09.2025.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR